



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa  
Z/ znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave te nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në  
bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

**F T O J**

Mbledhjen e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më  
23.03.2022 (e mërkurë) duke filluar ne ora 10:00.

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Ndryshimet e mjeteve të caktuara buxhetore transferet dhe subvencionet për dhënjen e ndihmes momentale pér njerëzit në nevoj;
3. Shqyrtimi i draft Rregulloren pér organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;
4. Raporti i punës nga Kompania EcoHigena;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:18.03.2022  
Në: Novobërdë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
Komuna e Novobërdës  
Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 16.02.2022, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović ,Anëtarët e KPF-së: Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanoviq, Abdyl Gashi, Nënkyryetari i Komunës z.Svetislav Ivanovic, Drejtori i Financave z.Milosh Denic, Drejtori i Shërbimeve Publike z.Gafurr Villasaliu.

Kryesuesja pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë 4 anëtarë të KPF-së ,konstaton se ka kuorum për punë dhe filloj mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Propozim plani i punës së Kuvendit;
2. Raporti Vjetor Financiar;
3. Aktivitete rrith luftimit të pandemisë;
4. Raport nga D.SH.P.M.SH. për tejkalimit të situatave aktuale nga reshjet e borës;
5. Formimi i komisionit për vlerësimin e dhënjen së tokës Komunale në shfrytëzim;
6. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave;
7. Formimi i komisionit për emërimin e rrugëve
8. Të ndryshme.

Pasi nuk pat ndonjë propozim për rendin e ditës së KPF-së fillohet me:

**Pika e parë:** Propozim plani i punës së Kuvendit;

Kryesuesja tha: në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kem formuar komisioni për punë në këtë pikë kem pas edhe drejtor të drejtoreve dhe janë dhënë propozim në resorët e tyre për tërë vitin,kurse plani e keni marr të gjithë me dokumente e juia dhe e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi propozoi që në këtë plan të shtohen për raportim të gjitha drejtorit duke e dit se Komuna e Novobërdës ka gjithësejt nëntë (9) drejtori si dhe të jen transparent ndaj vendit dhe qytetarëve të kësaj Komune që këto drejtori të raportojnë në çdo mbledhje.

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović për sa keni mundur me kuptua janë të cekura raportimet sidomos sa i përket drejtorisë së Financave kur jepet raportim çdo tre muaj çdo gjashtë dhe vjetore ,kurse drejtorit tjera p.sh. kemi drejtorin e Bujqësi që raporton në shtator pas përfundim të korrijeve shirjeve pastaj pregaditet e mbjelljeve dimërore a po vjeshtore kurse në çdo muajin e dytë e kem lënë hapësirë raportim nga ana e drejtorive që do të na interesoj për të thirr në raportim si dhe e kem mundësin çdo të dytën mbledhje një ose e më shum drejtori e kem lan mundësin në propozim planin, ky plan nuk është i pa ndryshushem do të ketë mundësi edhe pas të dërgohet në kuvend të ketë ndonjë ndryshim.

Nënkyryetari i Komunës z.Svetislav Ivanovic tha: e shfrytëzoj rastin ti përshëndet të gjithë anëtarët e KPF-së ashtu si e tha edhe kryesuesja që është mbledhja e parë e KPF-së në këtë mandatë, dëshiroja që në emrin tim t'u urojë mandatin dhe ju uroj shum sukses në punë dhe në fund që të kemi rezultate të përbashkëta dhe korrekt dhe të mira .

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović faleminderoj Nënkyetarin e Komunës për pjesëmarje në mbledhjen e parë, rikthehem a ka dikush tjetër të diskutoj sa i përket pikës së parë të rendit të ditës.

Abdyl Gashi pasi përshëndeti të pranishmit dhe uroj koleget punë të mbarë të KPF-së po besoj që ndryshimi jon edhe për propozim dhe planifikim do ta kem mundësi të japid edhe ne mbledhjen e Kuvendit, sa i përket raportimit të drejtorëve të caktuar ata normalisht që kanë obligim sa herë që sa herë ti fton KPF-ja ,po edhe Komuniteti për Komunitet edhe pse mandatin e kaluar ka qenë i anashkaluar nga KPF-ja nuk janë marrë parasysh edhe kërkeshat e tyre,gjithashtu është edhe një komiteti i rëndësishëm që është dashtë të vij si pikë e rendit të ditës ajë është komiteti për Siguri dhe Bashkësi që janë të përfshira Hoxha,Prifti ,Kryetari,dhe të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve .Mandati i kaluar nuk e kem pas këtë komitet.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri nga antarët prezent të KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

**Pika e dytë:** Raporti Vjetor Financiar **Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović** në këtë pik fton Drejtori i Financave z.Milosh Denic pasi përshëndeti të pranishmit dhe tha se para jush e keni reportin financiar për viti 2021 dhjetorë me kahasim me rapportet tre mujore dhe gjashtë mujore kjo është një formë ndryshe formë e standardizime si dhe janë përfshirë të gjitha kodet buxhetore ,po kalojmë te neni 14 të ajo tabele janë të përfshira 90% të shpenzimeve dhe qarkullimeve financiare komunale aty keni buxhetin final në fribalanc si dhe forma e realizimi të këti buxhetit si te hyrat dhe të ndaluarat në mënyrë detale tabelë mbas tabelë janë zbërthyer aty kem edhe te hyrat ton kapitale si dhe të ndalurat,të hyrat për këtë vit që janë bartur për ketë vit ,grandë e donatorëve të gjitha janë na reportin në shënim me listë të punësuarve ,nume që nuk janë me kontratë vepër. Të tabelë me shifra 84 janë 84.000€ të hyra çdo shifër është me nga 1000,në tabele me faqe nga 3 dhe 5 janë cekë numra me një mishie 84.700€ kem pas të hyra po sistemi automatikisht po e benë 84.000,sistemi e kthen 84.300 në këtë shifër ne jem edhe -300 € ky është svarim që ju ta keni ma të qarta për tabela e ma vonshëm,260.000€ janë të hyrat tatimore 332.400 €gardon te ndryshme,2.701.000€ rruga dhe mëditje ,mallra dhe shërbime 309.000€,shpenzime komunal 70.000€,trasfere dhe subvencionet 53.000€ investimet kapitale 400.000 të gjitha këto i keni në tabela të svarime.

Pas hapjes së diskutim nuk patë atëherë hedhet në votim me katër vota për dhe asnë kundër kjo pike e rendit të ditës shkon në Kuvendë.

**Pika e tret:** Aktivitete rreth luftimit të pandemisë Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović tha se që e kem parapa edhe ne planin e punës për çdo muaj për arsy se ende kem Covid ,po në KPF-ë po e shikojmë që nuk kem prezent dike na drejtoria e shëndetësi ose të kryesisë së shtabit së kësaj dukuri,kryesuesja hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha se edhe unë edhe Nënkyetari jem pjesë e ekipit të shtabit edhe nga drejtoria e Arsimit të vij dikush në Kuvendë se si është gjendja me Covid të na raportoj.

Pasi nuk patë ma shum diskutim hedhet në votim edhe kjo pik me katër vota për dheasnë kundër ose apsetim kjo pike e rendit të ditës shkon në Kuvendë.

**Pika e katërt:** Raport nga D.SH.P.M.SH. për tejkalimit të situatave aktuale nga reshjet e borës pasi përshëndetë të pranishmit,duke e dit që komuna nuk ka pas kompani që ti mirëmban rrugët nga reshjet e bores rrugët lokale ,kurse rrugët regionale kanë qen kompania e kontraktume dhe i ka mirëmbajt që nga data 22.01.2022 ne si drejtorat kem një traktor dhe kem punuar në të dy nderimet ku kem pastruar dhe ne si komunë kem kontraktume një kompani me 200 metra rrugë ta pastroj ,kurs derë tani na ka mbete vetëm një rrugë pa pastruar dhe kem bërë zgjidhje kem pastruar një rrugë alternative për shfrytëzim ky banor ,shfrytëzoj rasti ti faleminderoj ekipin e komunës punëtorë e shërbimeve publike ,një ashtu ekipin e zjarrfikësve edhe Kryetarin e komunës.

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonovic faleminderoj dhe tha se me vjen mire që nuk ka qen ndonjë problem i madh sa i përketë mirëmbajtës së rrugëve keni bërë zgjedhje për tejkalim situatës dhe kem përgjegjësi ndaj qyftereve për t'ju gjendur pran.

Abdyl Gashi bëri pyje cila kompani ka kontraktua komuna dhe kërkoi vlerën sa ka kushtuar ajo kompani? D.SH.P.M.SH z. Gafurr Vllasaliu Kompania është Zuka Kompani me një marveshje me Kryetarin në vlerë 5€ në kilometër ,ka kërkuar vetëm naftën për arsy me mos mundësimit të pagesë .

Pas diskutimit hedhet edhe kjo pikë në diskutim me tri (3) vota për edhe një(1) i përmbajtur dhe asnë kundër kjo pikë e rendit të ditës shkon në kuvendë.

**Pika e pestë:** Formimi i komisionit pér vlerësimin e dhënjen së tokës Komunale në shfrytëzim; Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonoviç tha qysh e din edhe mandatin e kaluar ka pas komision ku kanë që dy anëtarë e kuvendit dhe një nga shoqëria civile, kështu që edhe në këtë mandat duhet formohet komision i ri ,në Kuvendë duhet të propozohen cilat do të jen emrat dhe shpresoj që do të zgjidhet dhe do të punoj, unë kam qen mandatin e kaluar kem punua kem pas disa pengesa dhe hap diskutimi.

Pranvera Kastrati Gashi kërkon që të fuqizohet vendim i mëparshme i qeverisje së kapura

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonoviç në Kuvend se di a ke lexuar sipas ligjin e formim e komisionit ky komision ka mandat deri ne mandatin ne largim ,pastaj kur vi mandati i ri duhet edhe komisionet te zgjidhën të reja, se ka anëtar qe kanë qen po tash nuk janë anëtarët të përbërjes së Kuvendit

Abdyl Gashi uron që këto komisione kur të zgjedhën të mos jen vetëm në letër ,që nga pas lufta e deri këndej që komisioni ta bez vlerësim e pronave të shfrytëzime, keq menaxhuara ,deri tanë asnjë qeverisje ska punuar pér këtë çështje, ta kem një pasqyre të qartë se nga janë pronat e komunës të uzurpuara dhe të mos jen si mandatin e kaluar ,ndoshta kem te bejm edhe me ndonje individ që i ka kushte e vështira dhe ra rindërtua ndonjë shtëpi të vogël sa me jetua ,por është e pafalshëm që dikush e keqpërdore, të formohen komisione dhe standarde ligjor pér punë dhe funksionalizmi të komisionit

Pas diskutimit hidhet edhe kjo pikë në diskutim me katër (4) vota dhe asnjë kundër kjo pikë e rendit të ditës shkon në shqyrtim në kuvendë.

**Pika e gjashtë:** Formimi i komisionit pér shqyrtimin e ankesave kjo pik e rendit ditës ka lidhshmëri me pikën e pestë duke pas parasysh se me rregulloren pér dhërien e tokës në shfrytëzim është e paraparë edhe formimi i komisionit pér pranim dhe shqyrtimin e ankesave .Kryesuesja e përshkruan procesin e aplikimit të individëve dhe qytetarëve pér kërkësë dhe deri tek ankesë dhe tek komisioni dhe anëtarët të cilat duhen me qen nga anëtarë të kuvendit dy dhe një nga shoqëri civile.

Pasi nuk patë diskutim me katër (4) vota dhe asnjë kundër kjo pikë e rendit të ditës shkon në shqyrtim në kuvendë.

**Pika e shtatë:** Formimi i komisionit pér emërimin e rrugëve;

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonoviç tha se një ndër dy komunat në territorin e Kosovës jemi pa emrin të rrugëve lokale ,në mandatin e kalume kem pas komisioni ,jem takuar në dy tri herë ,po pér shkak të pandemisë nuk kem pas mundësi të mbajmë takime me qytetare që ata ti japim propozimet e veta ,kështu që kogjo pune është bërë dhe besoj që komisioni që do të formohet të vazhdoj aty ku e kemi lan ,dhe jam e bindur që nëse ky komision punon serioz do ti kem edhe emërimin e rrugëve.

Abdyl Gashi tha se kryesuesja veç i përmendi defekte që kanë qen ,kurs kjo tanë është dashtë të harrohet si punë besoj që e pengon edhe vete shtetin e Kosovës pér integrim ,nuk është edhe territorin aq i zgjeruar edh e që ka banor shum që kjo qeshte të mos përfundoj brenda dy muaj ose tere,që të fitohen qytetet dhe te merren me propozimet e tyre të atyre rrugëve ta kem parasysh edhe menaxhimi i situatës se kem propozim te ndryshme nga qytetaret edhe mos pajtime të propozimeve të emrave të rrugëve

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonoviç sqaroj që mu kjo çështje ne dhënies se emrat e me ligjin nuk ka qen të lejuar edhe pjesa tjeter pandemi ka qëne e pa mundur me vazhduar edhe pse një pjesë e madhe e punës është përfunduar ky komision ka mi mbet të vazhdoi vetëm aty ku mbet.

Konstatojmë që me katër (4) vota dhe asnjë kundër kjo pikë e rendit të ditës shkon në shqyrtim në kuvendë.

**Pika e tete:** të ndyshme;

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonoviç tha se keni marr edhe Planin e punë së KPF-së ku ,mbledhja e KPF-së të mos mbahen të Premten dhe ditëve të festave një kohështë edhe koha e mbajtje së mbledhjeve ndërron ka ora 11:00 që është parapa të ndërrohen në ora 10:00 është gabim teknik. Kam edhe një propozim e din që po i afrohemë 8 Marsit dita e gruas edhe ka mbet si traditë që edhe ne si Kuvendë anëtarëve tonë tija japim nga një dhuratë modeste pér këtë ditë. Në kuvend kemi 50 me 50 e keni fatin që edhe gruan keni Kryetaren e Kuvendit,unë personalisht mund të them si grua gjatë këtyre viteve në kuvend kam pas respekti e Respekti dhe ne komunë e Novobërdës nuk ka diskriminim nga ana tjeter. Vitin e kaluar kem pas një vlerë kupon me 50€ dhe vetëm në një dyqan ,ku aty pér të marr diçka është dashtë të shtohen para ,unë personalisht me ka mbet pa shpenzuar skam marr asgjë ,kurse kjo ide me qëndrua me kupon po diku ne

mundësit dyqan tjera me makete tjerash si janë Viva, Agmi, Etc, që femrat ka mundësi të marinë çka të dojë ndonje çamtë apo diçka tjetër kozmetik etj.

Kjo pik nuk do të shtohet si pik e rendi të ditës po do të diskutohet në piken e rendit të ditë të ndryshmet po vetëm desha ta informoj KPF-ën

Hapet diskutim tek të ndryshmet

Abdyl Gashi tha se edhe herën e kaluar e kam propozuar që mos krijohet një përshtypje tek qytetaret që gjithçka çka lidhët më buxhetin e komunë nga asambleistete deri tek zyrtar i thjeshtë, kam kërkuar që disa nene që rrisin jetimë qoftë në komunitet sérbi, shqiptar që një vlerë mëjor nga 10€ ose 20€ tu jepet kjo ndihmë e vogël, unë jam kundër kësaj, sa do pak ne një pagë kurse dikush nuk merë hiq.

Kryesuesja e Kuvendit Mirjana Simijonović e di që shum herë koleg e ka propozuar këtë çështje, por duhet të kem një listë sa përsona tillë kemi në Komunë e Novobërdës që ta di saktë numrin e tyre çfarë kategorie janë jo te mendojmë vetëm ne 8 Mars po për tërë vitin.

Pasi përfundimit të diskutimit Kryesuesja i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

Procesmbajtëse  
Arbenita Llapashtica

Kryesuesja Kuvendit  
Mirjana Simijonović

